

Tiranë, më datë 18.05.2020

REKURS

Kundër Vendimit nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit

Paditësi/Rekursues: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (SH.K.GJ.R.SH), regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008, përfaqësuar me autorizim nga **Z. Florjan Kalaja** me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe **Z. Engert Pëllumbi**, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe njëkohësisht nënkryetar i SH.K.GJ.R.SH. Adresa e njoftimit pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.¹

I paditur: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Person i tretë: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Objekti i padisë:

1. Konstatimin e cënimit të statusit të gjyqtarit nëpërmjet heqjes së pasaportës së shërbimit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”, si një drejtë e fituar e që “nuk mund të ulet”, në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e Lidhjes 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit” në pjesën që nuk parashikon gjyqtarët si subjekte zyrtarë që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi.
3. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019 “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit” në pjesën që parashikon se pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të lëshuara para datës 14 Qershor 2019 humbin vlefshmërinë me datë 31 Dhjetor 2019.

Baza ligjore e padisë: Nenet 4, 116, 118 dhe 138 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet 1, 2, shkronja “gj”, 10 dhe 22 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 2, pika 3, 7, shkronja “a”, 10, pika 2, shkronja “b”, neni 15 shkronja “d”, neni 17, pika 1, shkronja “a”, neni 18, pika 3, neni 37, pika 3 dhe 4, neni 40, pika 1, shkronja “a”, dhe neni 43, pika 2, e Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹ Njoftimi i komunikimeve do të bëhet pranë vendit të punës ku aktualisht ushtrojnë detyrën e Këshilltarit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë përfaqësuesit Z. Florjan Kalaja dhe Z. Engert Pëllumbi.

Objekti i rekursit: Ndryshimin e Vendimit nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe pranimin e padisë.

Baza ligjore e rekursit: Neni 58 dhe 63 i Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ”

PËRPARA

GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË

PËR

GJYKATËN E LARTË

Të nderuar z./znj. Gjyqtar/e!

Po Ju paraqesim më poshtë rekursin tonë duke parashtruar faktet dhe rrethanat, ligjin përkatës, ku jemi mbështetur, analizën dhe arsyetimin ligjor, për të arritur në konkluzionin se Vendimi nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit, duhet të ndryshohet dhe duhet të vendoset pranimi i padisë.

I. Faktet e çështjes

1. Pala paditëse, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si: “shoqata” apo “SHKGJRSH”), është një bashkim vullnetar gjyqtarësh (kryesisht të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit), e formuar sipas parashikimeve të nenit 39 të Kodit Civil² dhe nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar³ (më poshtë “ligji nr. 8788/2001”).

2. SHKGJRSH-ja është e organizuar si person juridik privat, në kuptim të nenit 26 të Kodit Civil⁴ dhe ka zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në përputhje me nenin 29 të Kodit Civil⁵ dhe nenin 14(1) të ligjit nr. 8788/2001⁶, pasi e ka fituar atë përmes vendimit nr. 2160, datë 25.01.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

3. Ndërkaq, pala e paditur, Këshilli i Ministrave, është organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv, i parashikuar në pjesën e pestë (nenet 95-107) të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kushtetuta”). Ai është person juridik publik, i organizuar në formën e institucionit, në kuptim të nenit 25(1) të Kodit Civil që iu jep këtë cilësi institucioneve e ndërmarrjeve shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji.

² Neni 39 i Kodit Civil ka këtë përmbajtje: “Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose me shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj.”

³ Neni 10, pika 1 përcakton: “1. Organizata jofitimprurëse me anëtarësi janë shoqatat. Organizatat jofitimprurëse me anëtarësi themelohen me vullnetin e lirë të personave fizikë ose juridikë. Numri minimal i anëtarëve themelues është 5 persona fizikë ose të paktën dy persona juridikë.”

⁴ Neni 26 i Kodit Civil parashikon: “Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar në ligj.”

⁵ Neni 29 i Kodit Civil lexon: “Personi juridik ka zotësi të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile që nga çasti i krijimit të tij dhe, kur ligji e parashikon se duhet të regjistrohet, që nga çasti i regjistrimit.”

⁶ Neni 14 i ligjit për organizatat jofitimprurëse, në lidhje me regjistrimin e tyre, sanksionon: “Organizata jofitimprurëse njihet si person juridik ditën që vendimi i gjykatës për regjistrimin e saj ka marrë formë të prerë.”

4. Ndërsa, personi i tretë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, është person juridik publik, në formën e institucionit, i krijuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, që ka miratuar dekretin e Presidentit të Republikës për përbërjen e Këshillit të Ministrave.

5. Në përmbushje të funksionit të tij kushtetues, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 335, datë 02.09.1997, “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit” (të ndryshuar), akt i cili ka dalë në bazë e për zbatim të Dekretit Nr. 7393, datë 12.6.1990 “Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave”. Kjo VKM përbën një akt normativ me karakter nënligjor. Në pikën 4 të kësaj VKM-je, ndër të tjera parashikohet se gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Më tej në pikën 11 parashikohet se: “Lëshimi i pasaportave diplomatike dhe të shërbimit ose zgjatja e afatit të vlefshmërisë së tyre bëhet kundrejt pagesës sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave. Këto pagesa përballohen nga organet, institucionet ose organizmat që kërkojnë lëshimin apo zgjatjen e afatit të vlefshmërisë të pasaportave për punonjësit e tyre.”.

6. Në përputhje me parimin kushtetues të lirisë së lëvizjes, të sanksionuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kushtetuta”), ligjvënësi ka miratuar Ligjin nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit” (më poshtë “ligji për pasaportat”).

7. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”, i cili ka dalë në bazë e për zbatim të Ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, është ndryshuar rrethi i subjekteve zyrtarë që gëzojnë të drejtën për shkak të funksionit të pajisen me pasaportë diplomatike dhe shërbimi. Ndër të tjera, në Lidhjen 2 të këtij akti nënligjor normativ, lidhje e cila parashikon listën e subjekteve zyrtarë që gëzojnë të drejtën të mbajnë pasaporta shërbimit, **nuk përfshihen gjyqtarët**. Për rrjedhojë nuk parashikohet më as përballimi i shpenzimeve për pajisjen me pasaportë të gjyqtarëve nga institucioni ku ato ushtrojnë detyrën. Në pikën 14 të këtij akti nënligjor normativ parashikohet se pasaportat e shërbimit të dhëna më parë do të kenë vlefshmëri deri me datë 31.12.2019.

8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit” (në vijim VKM nr. 389/2019) është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, të vitit 2019, ditën e premte, me datë 14 Qershor 2019. Në pikën 15, në paragrafin e dytë parashikohet se ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kjo do të thotë se VKM nr. 389/2019 ka hyrë në fuqi me datë 14 Qershor 2019.

9. Me datë 11.07.2019 Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve ka paraqitur padi kundër pjesës së aktit normativ nënligjor të mësipërm, që ka anuluar pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të dytë dhe kundër pjesës së vendimit që nuk përfshin gjyqtarët e shkallës së parë dhe të dytë në listën e subjekteve që kanë të drejtë të mbajnë pasaportat e shërbimit.

II. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit

10. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, ka vendosur: “1. Rrëzimin e padisë së palës paditëse, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë.”.

11. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar në vendim, ndër të tjera, se e drejta e gjyqtarit për mos cenimin e pagës dhe të përfitimeve të tjera është e drejtë kushtetuese dhe jo ligjore dhe se karakter kushtetues të konceptit “përfitime të tjera” të gjyqtarit i ka dhënë jurisprudenca e bollshme e Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet së cilës është detyruar ligjvënësi që të respektohet statusi kushtetues i gjyqtarëve. Duke vlerësuar se neni 22 i Ligjit nr.

96/2016 është thjeshtë përsëritje e nenit 138 të Kushtetutës, Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar se padia e palës paditëse në këtë rast nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, por është pjesë e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar se, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e drejta e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe e drejta e gjyqtarëve të gjykatës së apelit për t'u pajisur me pasaporta shërbimi, si pjesë e të drejtave të tjera të fituara prej tyre, që lidhen me statusin e tyre, është një e drejtë që mbrohet nga Kushtetuta dhe jo nga ligji i zakonshëm, duke konkluduar se Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve në padinë objekt gjykimi i ka ngritur pretendimet në nivel kushtetues dhe jo në nivel ligjor dhe se kompetent për shqyrtimin e këtyre pretendimeve është vetëm Gjykata Kushtetuese.

12. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese mbi kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve nënligjore normative e parashikon neni 131 shkronja "c" i Kushtetutës dhe nga ana tjetër edhe ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, i cili parashikon se kontroll incidental do të ushtrohet nga gjykatat e zakonshme, jo vetëm kur ligji vjen në kundërshtim me Kushtetutën, por edhe kur një antikushtetutshmëri e tillë konstatohet tek një akt nënligjor normativ. Gjykata Administrative e Apelit ka sjellë në vëmendje edhe nenin 8 të Ligjit nr. 49/2012, i cili ka përjashtuar juridiksionin gjyqësor nga shqyrtimi i çështjeve që i përkasin juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.

13. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se, duke qenë se ajo nuk ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj çështje, atëherë duhet të vendoset rrëzimi i padisë. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se në këtë rast nuk mund të shpallë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, sipas nenit 9 të Ligjit nr. 49/2012, pasi do t'i duhet t'i dërgojë në këtë mënyrë çështjen Gjykatës Kushtetuese për gjykim dhe se kjo normë gjen zbatim vetëm atëherë kur gjykata konkludon se nuk ka juridiksion, pasi çështja bën pjesë në juridiksionin administrativ dhe se për këtë arsye duhet ta dërgojë çështjen në organin administrativ kompetent. Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar se, sipas nenit 145 pika 2 të Kushtetutës, është e pamundur t'i dërgojë çështjen për gjykim Gjykatës Kushtetuese në këtë mënyrë, pasi ato legjitimohen t'i drejtohen asaj vetëm në rastet e kontrollit kushtetues të ligjit. Në këto kushte, konkludon Gjykata Administrative e Apelit, i vetmi disponim korrekt i saj mbetet të jetë rrëzimi i padisë.

14. Për të mbështetur këtë vendimmarrje të saj, Gjykata Administrative e Apelit ka sjellë në vëmendje Vendimin nr. 00-2010-3151 (436), datë 02.12.2010, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili në një rast të ngjashëm ka konkluduar se, bazuar në nenin 326 të Kodit të Procedurës Civile, kur padia është ngritur ndaj një akti administrativ ndaj të cilit nuk mund të ngrihet padi, duhet të vendoset rrëzimi i padisë dhe jo të shpallet moskompetenca e gjykatës.

III. Vlerësimi ligjor

15. Pala paditëse rekursuese vlerëson se argumentet e përdorura nga Gjykata Administrative e Apelit për të mbështetur vendimin e saj dhe vendimmarrja e këtij forumi gjyqësor janë të gabuara dhe, për këtë shkak, Vendimi nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit, duhet të ndryshohet, duke u vendosur pranimi i padisë sipas objektit të saj.

a) Në lidhje me juridiksionin e pushtetit gjyqësor për shqyrtimin e kësaj çështje

16. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se çështja që është investuar pranë saj në bazë të padisë së ngritur nga SHKGJSH nuk i përket sferës së pushtetit gjyqësor por është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar në thelb se statusi i gjyqtarëve ka një

natyrë kushtetuese dhe argumentet për këtë qëllim janë ngritur në nivel kushtetues dhe jo të ligjit.

17. Pala paditëse rekursuese çmon se një argumentin i tillë është krejtësisht i gabuar dhe i pambështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që përkufizojnë dallimin ndërmjet juridiksionit të gjykatave të zakonshme me atë të Gjykatës Kushtetuese.

18. Statusi i gjyqtarit nuk mundet të pretendohet se është një fushë ekskluzive e rregullimeve kushtetuese sepse nëse do të ishte kështu nuk do të kishte vend për ligjin e statusit të gjyqtarëve (shih Ligjin nr. 96/2016 i ndryshuar), ligj që e parashikon shprehimisht se do të ekzistojë ngaherë pikërisht vetë neni 81, pika 2, shkronja “e” e Kushtetutës. Në këtë mënyrë nuk do të kishte kuptim as ligji për pushtetin gjyqësor (shih Ligjin nr. 98/2016), as ligji për organet e sistemit të drejtësisë (shih Ligjin nr. 115/2016 të ndryshuar) dhe as rregullime të tjera eventuale ligjore apo nënligjor. Kushtetuta nuk është dhe nuk mundet të jetë dokument normativ me karakter shterues për rregullimet që bën. Përkundrazi ajo është gjithnjë vetëm dokumenti normativ themelor dhe se çdo gjë tjetër duhet të rregullohet nga ligji.

19. Sikurse mundet të konstatohet në pjesën e bazës ligjore të padisë dhe në pjesën arsyetuese të saj, pretendimet e palës paditëse rekursuese lidhen me shkelje të ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe se pikërisht statusi ligjor i cenuar nga vendimmarrja e Këshillit të Ministrave gjen mbështetje në nenin 138 të Kushtetutës, pasi neni 22 i Ligjit nr. 96/2016 ka dalë në bazë dhe për zbatim të kësaj dispozite kushtetuese.

20. Vendimi i Këshillit të Ministrave objekt padie është e vërtetë që nuk ka dalë në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 96/2016, por vendimi në fjalë e ka shkelur këtë normë supreme dhe për rrjedhojë duhet të shfuqizohet. Kur Gjykata Kushtetuese apo Gjykata Administrative e Apelit shqyrton pretendimet e palës iniciuese të gjykimit për jokushtetutshmëri apo paligjshmëri të aktit nënligjor normativ nuk mundet të kufizohet vetëm në konkluzionin nëse akti e ka zbatuar ligjin që ka të vendosur në trupin e tij si preambulë, duke individualizuar sakaq se në bazë dhe për zbatim të kujt ka dalë. Nëse do të pranohej kjo si e vërtetë atëherë do të mjaftonte qëndrimi kursimtar në shkelje nga ana e aktit nënligjor normativ të ligjit që mekanikisht vendos të tregohet në pjesën e preambulës, për të treguar se ka dalë në bazë dhe për zbatim të tij, duke mos u kursyer më në kundërshti me çdo ligj të papërmendur në preambulë. Ky qëndrim është jokushtetues dhe i paligjshëm. Akti nënligjor normativ duhet të zbatohet çdo ligj në fuqi, edhe ato që ka në preambulë dhe ato që nuk i ka, për arsyen e thjeshtë se është akt nënligjor normativ, dhe se në hierarkinë e akteve normative qëndron poshtë ligjeve (shih nenin 116 dhe 118 të Kushtetutës).

21. Lidhur me argumentin për ndarjen e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Administrative të Apelit, vlerësojmë se, pavarësisht qëndrimeve doktrinare mbi të drejtën, fuqi juridike ka interpretimi kushtetues dhe ligjor i Kushtetutës dhe ligjit i formësuar tashmë prej vitesh në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në këtë praktikë gjyqësore gjykatat e pushtetit gjyqësor kanë shqyrtuar edhe më parë legalitetin e akteve nënligjore normative të nxjerra nga organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, duke u kufizuar në natyrën e kërtimeve. Pikërisht kjo praktikë gjyqësore ka diktuar zgjedhjen e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve për të përzgjedhur aktin iniciues të procesit gjyqësor dhe më tej edhe forumin gjyqësor kompetent.

22. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, për herë të parë u parashikua një padi ndaj aktit nënligjor normativ në gjykatat e zakonshme. Kjo kompetencë iu ngarkua Gjykatës Administrative të Apelit, e cila në këtë rast do të gjykojë si shkallë e parë, si dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në rrugën e kontrollit të vendimit mbi bazën e rekursit (si shkallë e dytë).

23. Me fillimin e funksionimit të gjykatave administrative dhe, mbi të gjitha, krijimin e një gjykate të specializuar për të gjykuar ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ, u duk sikur problemi i kontrollit të ligjshmërisë së këtyre akteve u zgjidh një herë e përgjithmonë. Mirëpo ishte pikërisht prezantimi i juridiksionit fillestar të Gjykatës Administrative të Apelit, në gjykimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore normative, si një mjet i ri në rendin juridik shqiptar, ai që futi konfuzion në praktikë por edhe në diskutimet teorike të çështjes, duke ngritur shumë dilema.

24. *“Parashikimet e Kushtetutës (neni 131/c) dhe të ligjit për gjykatat administrative, që përcaktojnë juridiksionin ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave administrative, në drejtim të shqyrtimit të vlefshmërisë së akteve nënligjore normative, evidentojnë jo vetëm një raport ndërmjet kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, por krijojnë edhe mundësinë për një mosmarrëveshje juridiksionale ndërmjet gjykatave”.*⁷

25. Pyetjet që rëndom do të shtroheshin në këtë situatë do të ishin: ku mbaron paligjshmëria dhe ku fillon antikushtetutshmëria e një akti normativ nënligjor, apo cilat janë kriteret për të bërë dallimin ndërmjet paligjshmërisë dhe antikushtetutshmërisë së aktit nënligjor normativ, duke dalluar sakaq juridiksionin e Gjykatës Administrative të Apelit nga juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese.

26. Përgjigja më naive në këtë rast do të ishte se paligjshmëria ndodh në ato raste kur akti nënligjor normativ vjen në kundërshtim me formën, procedurën, kompetencën e organit që ka për detyrë ta nxjerrë, sikurse parashikohet në ligj, si dhe me përmbajtjen e qëllimin e ligjit, ndërsa antikushtetutshmëria kur përmbajtja e aktit vjen në kundërshtim me parimet dhe normat konkrete kushtetuese. Rrjedhimisht edhe juridiksioni ndërmjet dy gjykatave do të përcaktohet nga lloji i defektit që akti paraqet, i pretenduar në mjetin e përdorur nga subjekti përkatës për të aksesuar në gjykatë.

27. Vlerësojmë se një zgjidhje e tillë është krejtësisht formaliste dhe nuk mban në konsideratë simbiozën paligjshmëri – antikushtetutshmëri. Gjithashtu, ajo nuk i jep përgjigje pyetjes se si do të përcaktohet juridiksioni ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Administrative të Apelit në rast se subjekti përkatës ngre si pretendim edhe paligjshmërinë edhe antikushtetutshmërinë e aktit nënligjor normativ të kundërshtuar prej tij. Për këtë nuk mund të kemi një përgjigje nga një ndarje e tillë mekanike ndërmjet paligjshmërisë dhe antikushtetutshmërisë.

28. Doktrina juridike si dhe jurisprudenca gjyqësore janë përpjekur që të ofrojnë zgjidhje të ndryshme, nisur nga qasjet që kanë pasur rreth tematikës, por pa arritur që të japin një përgjigje përfundimtare.

29. Një mendim i dhënë nga doktrina, i cili ka dominuar edhe në praktikën e Gjykatës Administrative të Apelit⁸, është ai se ndarja ndërmjet dy juridiksioneve do të bëhet bazuar në llojin e pretendimit të ngritur nga kërkuesi, përkatësisht nëse kërkuesi pretendon paligjshmërinë apo antikushtetutshmërinë e aktit nënligjor normativ.

30. Sikurse jemi shprehur më lartë, një ndarje e tillë ndërmjet juridiksioneve është mekanike dhe formaliste, nuk mban parasysh dualizmin paligjshmëri – antikushtetutshmëri dhe, për më tepër, nuk i jep zgjidhje situatës në të cilën subjekti iniciues i procesit pretendon njëkohësisht paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e aktit nënligjor normativ të kundërshtuar prej tij.

31. Një tjetër mendim i dhënë në praktikën gjyqësore ka qenë ai që ndarjen ndërmjet juridiksioneve e ka bërë bazuar në parimin e subsidiaritetit. Sipas këtij mendimi gjykimi kushtetues nga natyra është një gjykim subsidiar (kompelementar) dhe si i tillë mund të investohet vetëm kur subjekti iniciues i procesit nuk ka më mjete të tjera juridike në

⁷ Sadushi, Sokol, “Gjykata administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën”, Botimet Toena, Tiranë, 2014, faqe 213.

⁸ Shih vendimet nr. 111, datë 6.5.2019 dhe nr. 191, datë 15.7.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

dispozicion. Jemi të bindur se ky qëndrim bën ndarjen më të saktë ndërmjet dy juridiksioneve, atij të Gjykatës Administrative të Apelit (pushtetit gjyqësor) me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Për këtë shkak, kjo duhet qasja e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në vendimmarrjen e saj për këtë çështje.

32. Referuar nenit 124 të Kushtetutës, misioni i Gjykatës Kushtetuese konsiston në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe realizimin e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës. Juridiksioni i kësaj gjykate mund të investohet vetëm kur nuk ekzistojnë mjete të tjera juridike për të zgjidhur një mosmarrëveshje me natyrë kushtetuese ose kur këto mjete janë ezauruar në mënyrë të pasuksesshme.

33. Neni 131 i Kushtetutës përcakton kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, ndër të cilat dhe kompetencën për kontrollin kushtetues ndaj akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare (neni 131/c). Në pamje të parë, në këndvështrimin literal, neni 131 i Kushtetutës nuk kërkon shterimin e mjeteve për subjektet që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për kontrollin abstrakt të akteve nënligjore normative, në ndryshim nga kontrolli i kërkesave të individëve për shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, ku kjo kërkesë është e përcaktuar qartë (neni 131/f).

34. “Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese, siguron epërsinë e Kushtetutës në sistemin ligjor. Interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është një nga funksionet e rëndësishme të kësaj Gjykate dhe ajo e ushtron këtë kompetencë sa herë që vihet në lëvizje për t’u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Shprehja “interpretimin përfundimtar” nënkupton se Gjykata Kushtetuese është instanca e fundit dhe, për rrjedhojë, vënia në lëvizje e saj, si rregull, duhet të bëhet pasi organet e tjera shtetërore të kenë mbajtur qëndrim për zbatimin e dispozitës kushtetuese. Ky kuptim është në harmoni dhe me përmbajtjen e nenit 4/3 të Kushtetutës”.⁹

35. “Për analogji, Gjykata, në jurisprudencën e saj ka theksuar se në rastin e shqyrtimit të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, ajo udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit. Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit)”.¹⁰

36. “Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shteruar mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi”.¹¹

37. “Parimi i subsidiaritetit është konsideruar si një vlerë e nënkuptuar kushtetuese në themelet e një shoqërie demokratike. Ai mund të jetë subsidiaritet institucional apo subsidiaritet juridiksional. Subsidiariteti institucional si parim ligjor është i konsoliduar dhe nënkupton që një organ gjithëpërfshirës më i lartë nuk duhet të merret me një çështje që një organ tjetër më i ulët mund të merret dhe ta zgjidhë atë në mënyrë efektive”.¹²

⁹ Shih për më gjerë mendimin e pakicës në vendimin nr. 60, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹⁰ Shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014, dhe nr. 3, datë 26.1.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

¹¹ Shih vendimin nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

¹² Benda, Ernst, Maihofer, Werner dhe Vogel, Hans, “Handbuch des Verfassungsrechts”, edicioni i dytë, 1995.

38. “Subsidiariteti juridiksional është një instancë e subsidiaritetit institucional dhe ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësisë për të gjykuar juridiksioneve të ndryshme. Koncepti i subsidiaritetit ka një rol konstruktiv në gjykimin dhe interpretimin kushtetues. Në jurisprudencën kushtetuese gjermane, subsidiariteti institucional pengon Gjykatën Federale të gjykojë mbi çështje për të cilat një juridiksion tjetër mund të vendosë”.¹³

39. Për sa u përshtrua më sipër, arrijmë në përfundimin se elementi që do të bëjë dallimin ndërmjet juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe atij të Gjykatës Administrative të Apelit do të jetë subjekti i cili inicion gjykimin përkatës. Në nenin 134 të Kushtetutës renditen subjektet të cilët mund të vënë në lëvizje këtë gjykatë. Referuar paragrafit të dytë të kësaj dispozite ata ndahen në subjekte me legjitimitet të pakushtëzuar dhe në subjekte me legjitimitet të kushtëzuar. Ndër subjektet me legjitimitet të kushtëzuar përfshihen organizatat dhe individët.

40. Nga ana tjetër, në nenin 15 të ligjit për gjykatat administrative janë renditur subjektet të cilat mund të vënë në lëvizje gjykimin administrativ. Në rrethin e subjekteve të legjitimuar janë shoqatat, grupet e interesit dhe individët. Shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje gjykimin administrativ, së bashku me grupet e interesit, kjo e drejtë e tyre më së pari u njihet për të kundërshtuar një akt nënligjor normativ, në një gjykim abstrakt, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

41. Përpara miratimit të ligjit për gjykatat administrative, shoqatat dhe grupet e interesit, për mbrojtjen e interesave të tyre nga një akt nënligjor i paligjshëm apo antikushtetues, nuk dispononin një mjet tjetër përveç kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të realizuar një gjykim abstrakt sipas nenit 131/c të Kushtetutës. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji tashmë ato janë të detyruara që, përpara se t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të një akti nënligjor normativ, fillimisht të shterojnë juridiksionin e Gjykatës Administrative të Apelit si dhe atë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

42. Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që paraqiten përpara saj, mund të jetë ekskluziv (fillestar) ose subsidiar (rishikues). Siç u theksua më sipër, juridiksioni i kësaj gjykate nga natyra është subsidiar, me përjashtim të rastit kur rendi juridik nuk parashikon mjete të tjera për mbrojtjen e parimeve kushtetuese si dhe të drejtave e lirive themelore. Nëse subjektet iniciuese të gjykimin kushtetues kanë në dispozicion mjete të tjera, atëherë ato duhet që më parë të shfrytëzojnë këto mjete përpara se të investojnë juridiksionin kushtetues.

43. Gjykimi i pajtueshmërisë së akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare sipas nenit 131/c të Kushtetutës përbën një juridiksion ekskluziv (fillestar) të Gjykatës Kushtetuese. Si i tillë ai nuk kërkon shterimin e mjeteve të tjera juridike me qëllim që të vihet në lëvizje. Megjithatë, nisur nga natyra subsidiare që ka gjykimi kushtetues në parim, ky juridiksion nuk mund të iniciohet nga njëri prej subjekteve që vënë në lëvizje këtë gjykatë, nëse këto subjekte kanë mjete të tjera juridike për të kontrolluar pajtueshmërinë e akteve nënligjore normative me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

44. Në këtë mënyrë, shoqatat, grupet e interesit dhe individët nuk mund t’i drejtohen drejtpërdrejt juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 131/c të Kushtetutës, për kontrollin e pajtueshmërisë së akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, por duhet t’i drejtohen me padi Gjykatës Administrative të Apelit, më tej me rekurs Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për sa i përket subjekteve të tjera të parashikuara në nenin 134/1 të Kushtetutës, ata mund t’i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e aktit nënligjor normativ në një gjykim fillestar.

¹³ Hesse, Konrad, “Grundzüge des Verfassungsrechts der Bundesrepublik Deutschland”, 1993.

45. Për sa i përket akteve nënligjore me karakter të përgjithshëm të cilat mund t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, mbështetur në jurisprudencën e kësaj të fundit,¹⁴ do të jenë vetëm aktet nënligjore normative të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës. Në këtë mënyrë, me akte normative të organeve qendrore dhe vendore, të përmendura në nenin 131/c të Kushtetutës, për të cilat ka juridiksion kjo gjykatë, do të kuptojmë aktet normative nënligjore për të cilat bën fjalë neni 118 i saj.

46. Për çka u tha më sipër, Gjykata Administrative e Apelit, si pjesë e gjykatave të zakonshme (pushtetit gjyqësor) ka juridiksion për gjykimin e kësaj çështje.

b) Në lidhje me themelin e pretendimeve të palës paditëse

47. Në lidhje me themelin e pretendimeve të parashtruara nga ana e palës paditëse rekursuese, të cilat, në thelb, konsistojnë në cenimin e statusit të gjyqtarit, si pasojë e mohimit të një të drejtë të fituar më parë (gëzimi i të drejtës së disponimit të pasaportave të shërbimit), kjo gjen mbështetje plotësisht në bazën kushtetuese dhe ligjore të evokuar prej nesh si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Jo vetëm kaq, por edhe Gjykata Administrative e Apelit, në Vendimin nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, objekt i këtij rekursi, e konfirmon një gjë të tillë, duke i dhënë të drejtë palës paditëse, pavarësisht se në përfundim ajo ka refuzuar të japë drejtësi, duke hequr dorë nga juridiksioni që Kushtetuta dhe ligji nr. 49/2012 i kanë dhënë.

48. Statusi i gjyqtarit, si një nga elementët e pavarësisë së tij, përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet (kufizimet) që ai mbart për shkak të ushtrimit të këtij funksioni kushtetues. Ndër të drejtat që gjyqtarët gëzojnë, si pasojë e pasjes së statusit të tyre, janë paga dhe përfitimet e tjetra me natyrë financiare dhe jo financiare. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” merr përsipër mënyrën e përllogaritjes së pagës së gjyqtarëve si dhe disa prej përfitimeve të tjera financiare, duke qenë një ndër elementët më themelore të statusit të këtyre funksionarëve kushtetues. Ndërkohë, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, përkatësisht ligjvënësi dhe pushtetit ekzekutiv, mund të akordojnë privilegjeve të tjera për këtë kategori funksionarësh (gjyqtarët) si pjesë e të drejtave që burojnë nga statusi. Në momentin që këto privilegjeve, sikurse mund të jetë pasaporta e shërbimit apo ajo diplomatike, akordohen, ato bëhen pjesë e statusit të funksionarit në fjalë. Në një situatë të tillë privilegji, i dhënë me çdo lloj akti ligjor apo nënligjor, bëhet pjesë e statusit dhe nuk mund të cenohet më me akte të mëtejshme ligjore apo nënligjore. Të vetmet përjashtime për të cilat statusi mund të preket në aspektin përkeqësues janë parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës si dhe në nenin 22 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çka nuk provohet të ekzistojë në situatën konkrete.

49. Shtrirja e statusit të gjyqtarit edhe ndaj përfitimeve të tjera, krahas atyre me natyrë ngushtësisht financiare del jo vetëm nga përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës si dhe nenit 22 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por është konfirmuar edhe nga jurisprudenca konstante e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në disa vendime të saj kjo gjykatë është shprehur se me termin “përfitime të tjera”, duhen kuptuar jo vetëm ato me natyrë financiare por edhe të drejta të tjera, sikurse mund të jetë p.sh e drejta për karrierë e gjyqtarit, të cilat pasi u jepen u këtyre të fundit, nuk mund tu hiqen më, pasi mbrohen nga parimet kushtetuese të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të sigurisë juridike, të cilat në drejtim të gjyqtarit kanë krijuar koracën e statusit të tij.

¹⁴ Shih vendimin nr. 30, datë 2.3.2012, të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

50. Një nga parimet më të rëndësishme të sanksionuara në disa norma kushtetuese është edhe pavarësia e pushtetit gjyqësor. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është e sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete, por ajo lidhet me mirëfunksionimin e shtetit dhe të drejtën e shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës¹⁵.

51. Gjykata ka theksuar se statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht pa pëlqimin e KLD-së dhe disiplinuarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare¹⁶.

52. Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët parashikohet edhe në dokumente ndërkombëtare. Kështu, Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, "Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit" (miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe moshja e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme.¹⁷

53. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, neni 138 i Kushtetutës përcakton elementë përbërës të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit "përfitime të tjera" është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre¹⁸.

54. Bazuar në analizën e mësipërme, Gjykata vlerëson se karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre. Mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë¹⁹.

55. Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë, për shkak të funksionit. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Qëllimi i parimit të sigurisë

¹⁵ Shih vendimet nr. 31, datë 02.12.2009 dhe nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁶ Shih vendimet nr. 5, datë 16.02.2012; nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 dhe nr. 11, datë 27.05.2004 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁷ Shih vendimin nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Shih vendimin nr. 31, datë 02.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁹ Shih vendimin nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

juridike është të sigurojë besimin e personave te shteti e ligji dhe, vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë dhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës dhe garancisë²⁰.

56. Kushtetuta në nenin 138 të saj ka garantuar gjyqtarët lidhur me statusin e tyre, në pjesën e të drejtave që rrjedhin nga ushtrimi i detyrës, duke parashikuar se pagat dhe përfitimet e tjera nuk mundet të ulen. Në të njëjtën kohë ajo ka parashikuar edhe përjashtimet nga ky rregull si një rezervë kushtetuese. Përjashtimet nga ky rregull kushtetues janë: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko – financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit. Në të njëjtën mënyrë ka rregulluar dhe detajuar edhe Ligji nr. 96/2016, duke përfshirë në këtë garanci edhe magjistratët prokurorë.

57. Në rastin konkret konstatohet se gjyqtarët, ndër të drejtat që gëzonin për shkak të ushtrimit të detyrës dhe pjesë e statusit të tyre, ka qenë e drejta për t'u pajisur me pasaportë shërbimi dhe të drejtën që pajisja me pasaportë të realizohej me shpenzimet e institucionit. Ajo që ka ndodhur me VKM nr. 389/2014 është prekje e statusit të gjyqtarëve në dy elementë: **1)** Heqja e së drejtës për t'u pajisur me pasaportë shërbimi dhe për rrjedhojë heqja e së drejtës për të gëzuar të gjitha lehtësitë e pajisjes me këtë dokument shtetëror identifikimi; **2)** Heqja e përfitimit financiar të përballimit të pagesës së pajisjes me pasaportë shërbimi nga buxheti i institucionit ku gjyqtari ushtron detyrën.

58. Vlerësojmë se shkronja “b” dhe “c” e nenit 138 të Kushtetutës dhe nenit 22 të Ligjit nr. 96/2016 nuk ka relevancë kushtetuese dhe ligjore që të jetë përdorur dhe të jetë zbatuar në VKM nr. 389/2019. I vetmi shkak justifikues i legjitimitetit të VKM nr. 389/2019 është shkronja “a” e nenit 138 të Kushtetutës dhe nenit 22 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Kjo do të thotë se që të marrë legjitimitet ky akt nënligjor normativ do të duhet të ketë pasur një situatë të vështirë financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare. Një situatë e tillë, e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 138 të Kushtetutës dhe nenit 22 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

59. Për rrjedhojë konkludohet se VKM nr. 389/2019 në pjesën e “Lidhjes 2”, në pjesën që ka ometuar për të përfshijë gjyqtarët si subjekte zyrtarë që gëzojnë të drejtën për t'u pajisur me pasaportë shërbimi si dhe ku ka kufizuar të drejtën e përdorimit të pasaportave të shërbimit të gjyqtarëve deri në datë 31.12.2019, vjen në kundërshtim me nenin 138 të Kushtetutës dhe neni 22 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

60. Vlerësojmë se VKM nr. 389/2019 në pjesët e identifikuar më lart ka shkelur nenin 118 të Kushtetutës, duke qenë se kanë dalë në kundërshtim me vetë rezervën kushtetuese dhe rezervën ligjore të paprekshmërisë së statusit të gjyqtarëve.

IV. Konkluzioni

61. Të gjitha shkaqet ligjore të parashtruara në rekurs si më sipër përbëjnë bazë të mjaftueshme për arritur në përfundimin se Vendimi nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019,

²⁰ Shih vendimet nr. 11, datë 06.03.2014; nr. 9, datë 26.02.2007; nr. 11, datë 04.04.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 02.11.2005; nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

të Gjykatës Administrative të Apelit, është dhënë në zbatimin të gabuar të ligjit material, të një rëndësie themelore për njësimin, e praktikës gjyqësore. Sikurse u theksua më lart, praktika gjyqësore ka qenë tërësisht inkoherete dhe e ndryshme në lidhje me ndarjen e juridiksionit ndërmjet Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës Kushtetuese dhe për këtë shkak është vendi për njësimin e saj nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Ndërsa, për sa i përket themelit të pretendimeve të palës paditëse rekursuese, kërkojmë të lihet në fuqi pjesa arsyetuese e Vendimit nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila i ka dhënë të drejtë palës paditëse rekursuese lidhur me cenimin e statusit të gjyqtarit si pasojë e miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.06.2019, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”.

62. Sa më sipër u arsyetua, kërkojmë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ndryshimin e Vendimit nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe pranimin e padisë sipas objektit, duke u urdhëruar edhe botimi i vendimit në Fletore Zyrtare. Në këtë rast duhet të vendoset ndryshimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe jo prishja e tij, duke qenë se kjo e gjykatë i ka dhënë zgjidhje në thelb padisë, pavarësisht formës së disponimit dhe shkaqeve ku ai bazohet. Pra, me ndryshimin e këtij vendimi vetëm për sa i përket disponimit, vendoset pranimi i juridiksionit të pushtetit gjyqësor dhe lihet në fuqi arsyetimi i vendimit të rekursuar për sa i përket themelit të padisë, duke mos u ndryshuar sakaq kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

PADITËSI REKURSUES
SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR
NGA
ENGERT PËLLUMBI